



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosova

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosova Council for the Cultural Heritage



Në përputhje më nenet 1, 2, 4, të Ligji për Trashëgimi Kulturore, nenin 4 të Rregullores Nr.05/2008 Mbi Regjistrimin, Dokumentimin, Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje si dhe nenin 17 të Rregullores 01/2016 Për Punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në mbledhjen e datës 15 qershor 2016, Bordi i KKTK, miratojë këtë:

## RREGULLORE

NR.02/2016

### PËR VLERËSIMIN DHE SHPALLJËN E TRASHËGMISË KULTURORE NË MBROJTJE TË PËRHERSHME

#### NENI 1

#### QËLLIMI

1.1. Qëllimi i kësaj Rregullore është përcaktimi i kritereve dhe procedurave për vlerësimin dhe shpalljen e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përherershme.

#### NENI 2

#### PROCEDURA DHE FORMAT

2.1. Propozimi i aseteve për shpallje në mbrojtje të përherershme bëhet nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit (MKRS);

2.2. Të gjithë personat fizik dhe juridik kanë të drejtë të propozojnë asete të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përherershme sipas nenit 4.1 të Ligjit për Trashëgimi Kulturore;

2.3. Të gjitha propozimet nga personat fizik dhe juridik kalojnë një vlerësim paraprak nga Institucioni Kompetent (MKRS) sipas nenit 4.2 të Ligjit për Trashëgimi Kulturore dhe nenit 4.3 të Rregullores 05/2008 të Mbi Regjistrimin Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje;

- 2.4. Vetëmasetet që janë vlerësuar paraprakisht nga Institucioni Kompetent (MKRS) dhe janë pjesë e listës së mbrojtjes së përkohshme sipas nenit 3.6 te Ligjit për Trashëgimi Kulturore kanë të drejtë të propozohen për mbrojtje të përhershme;
- 2.5. Propozimet për aplikim duhet te behet sipas Formularit T1 dhe Draftit grafik (T2) të bashkangjitur në këtë Rregullore më të gjitha dokumentet përcjellëse;
- 2.6. KTKK nuk do te pranoj propozime më të vjetra se gjashte muaj nga dita e shpalljes në mbrojtje të përkohshme. Nga data e pranimit të propozimeve, KTKK në afatin e paraparë ligjor do të shqyrtoj dhe marr vendim;
- 2.7. Nëse kërkesa nuk është e kompletuar sipas Formularit T1 tëkësaj Rregullore, KTKK kërkon nga MKRS që në afatin prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve të plotësoj kërkesën më dokumentacionin përcjellës;
- 2.8. Te gjitha dokumentet e dorëzuara duhet te jene origjinale, tënënskruara dhe vulosura nga personat juridik ose fizik;
- 2.9. Formulari i aplikimit më dokumentacionin përcjellës pranohen nga zyrtari i autorizuar i Këshillit te Kosovës për Trashëgimi Kulturore, protokollohet nëlibër tëveçantë më numrin unik të KTKK-së;
- 2.10. Formulari i aplikimit më dokumentacionin përcjellësdozohet në dy (2) kopje fizike, Formati T1 me shtojcën e hartave dhe pjesës grafike T2 sipas përpjesës se cekur ne formularin T1 (origjinali dhe një kopje) si dhe një kopje elektronike;
- 2.11. Kopja elektronike duhet ti përbahet formave:
- 2.11.1. Hartat në formatin rasterik të jenë: JPG, ECW, TIFF, BMP (tëgjeoreferencuara)
  - 2.11.2. Hartat e formatit vektor duhet të jenë: \*.tab, \*.shp, \*.dwg, \*.dxf
  - 2.11.3. Të gjitha vizatimet e arkitekturës duhet të jene në formatet: DWG, DXF, PLN dhe PDF
- 2.11.4. Fotot duhet të jenë të formatit: JPG, BMP, TIFF, GIF, (300 dpi)
- 2.11.5. Pjesa tekstuale duhet të jetë në: Word dhe PDF, shkronjat Time New Roman, madhësia e shkronjave 12;
- 2.12. Për tëlëhtësuar procesin e aplikimit për shpallje në mbrojtje tëpërhershme të trashëgimisë kulturore KTKK do te krijoj formën elektronike online të formularit;
- 2.13. Grupet punuese do të bëjnë verifikimin e dokumentacionit dhe gjendjes fizike të aseteve të trashëgimisë kulturore në terren;

- 2.14. Grupi punës përgatit rekomandimin për Bordin e KTK për shpallje ose refuzim;
- 2.15. Bordi i KTK merr vendim për shpallje ose refuzim;
- 2.16. Vendimi për shpallje ose refuzim të aseteve të trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përhershme bëhet nga anëtarët e Bordit të KTK, sipas procedurave të parapara më Regulloren 01/2016 të KTK;
- 2.17. Vendimi nënshkruhet nga Kryetari i KTK;
- 2.18. Vendimi i KTK për shpalljen e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme i dërgohet Ministrit të Kulturës përfshirjen e aseteve të trashëgimisë kulturore në listën e mbrojtjes së përhershme;
- 2.19. Asetet e trashëgimisë kulturore të shpallura nga KTK e qe janë tëpërfshira në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme do të rishikohen çdo 5 vite dhe sipas kërkesave nga Institucionet Kompetente.

#### NENI 3

#### KRITERET

- 3.1. Për vlerësimin e aseteve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme do të përdoret Rregullorja Nr. 05/2008 Mbi Regjistrimin, Dokumentimin, Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje, si dhe standartet dhe kriteret e UNESCO. Pjesa grafike do te vlerësohet sipas standardeveteknike të BE-së, praktikave më të mira ndërkombëtare.

#### NENI 4

#### Dispozitat përfundimtare

- 4.1. Origjinali i dosjes së aseteve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme do të mbet në arkivin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, kopja se bashku me vendimin do të kthehet në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- 4.2. KTK do të krijoj një database të aseteve të shpallura si trashëgimi kulturore për nevoja të veta dhe për palët e interesuara;
- 4.3. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i KTK.

Shafi Gashi

Kryetar i KTK

Më 15 qershor 2016